

JAMARBËR HOXHA
NËN TINGUJT E VIOLËS
PROZA TË SHKURTRA DHE POEZI

BOTIMET TOENA

Libra të tjerë nga i njëjti autor:

AUVERNAMON
poezi (BOTIMET TOENA 2021)

DJALOSHI AUTIK
poezi (BOTIMET TOENA 2023)

JAMARBËR HOXHA

NËN TINGUJT E VIOLËS

proza të shkurtra dhe poezi

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Kopertina dhe përkujdesja grafike: Gea Qëndro

ISBN

© BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

PARATHËNIE

Letërsia jep gjithmonë mundësi të hapësh një dritare nga ku mund ta shohësh botën sipas mënyrës tënde. Të gjesh përtej horizontit gjëra që të ngazëllesh, t'i japësh dorë fantazisë e ta provosh emocionin e çdo mendimi që grumbullohet brenda teje e i jep formë dëshirave. Kjo nxitje e vazhduar për të eksploruar gjithçka rreth teje, kjo nevojë që me fjalë të veshësh krejt ekzistencën, e gjen shtegun e vet përmes krijimit letrar. E në këtë botë të re që krijon autori, struktura mund të ngrihet me rregulla klasike, me forma të njohura e të përdorura nga autorë të tjerë ose mund të formësohet nga një frymëmarrje e brendshme, nga një nevojë për të thënë botën ashtu siç ajo përjetohet. “Nën tingullin e Violës” i përket kësaj të dytës. Prozat e shkurtra dhe poezitë e këtij libri i përcillen lexuesit si një rrjedhë mendimi që hapet gradualisht, si një dritare që nuk kërkon të filtrojë dritën por është e hapur plotësisht për t'i dhënë ngrohtësi vështrimit. Jamarbëri i thotë gjërat sipas mënyrës së tij të përjetimit, me një frymë, duke dhënë një ritëm

që të bën të kapesh pas leximit e të kesh dëshirë të shkosh në faqen tjetër. Teksti lëviz brenda hapësirës ku fjalitë zgjerohen, ndjekin njëra-tjetrën, përforcojnë një emocion, rikthehen te një detaj, e mbajnë atë gjatë në vëmendje. Kjo mënyrë shkrimi i përket një bote të brendshme që organizohet ndryshe, që nuk e ndan jetën në segmente të shkurtra, por e përjeton si një vazhdimësi.

Në një moment të duket sikur merr në dorë një grusht fotografish të dikurshme, bardhë e zi, ku imazhet kanë mbetur të patrazuara nga koha. Të ngjan sikur arrin t'i shohësh njëra pas tjetrës dhe të mendosh se gjithçka është e ngrirë, e qetë, pa lëvizje të dukshme. Por kur i afroresh më shumë, dallon një dridhje të lehtë në sy, një tension të heshtur në gjeste, një histori që nuk shfaqet menjëherë. Brenda asaj qetësie ka jetë. E tillë është ndjesia që përçon ky libër. Në dukje, kemi përditshmëri: një mëngjes, një ëndërr, një fantazi e çastit. Por brenda kësaj sipërfaqeje pulson një dramë e brendshme, një dëshirë e thellë për të ndier, për të kuptuar, për të dashur. Jamarbëri kështu e përjeton botën. Ai ndalet gjatë mbi detajet, i shijon ngjyrat, tingujt, fytyrat me një përqendrim të thellë. Çdo ngjarje merr formë si një tingull i jetës. Ëndrrat e tij janë ritmike. Një takim, një buzëqeshje, një fjalë, një objekt i thjeshtë, të gjitha shndërrohen në nota të një muzike të brendshme që përhapet

në ajër dhe mund të dëgjohet vetëm nga ata që kanë durimin dhe ndjeshmërinë për ta kapur.

Mungesa e shenjave të pikësimit e lehtëson këtë proces, nuk ka asnjë pengesë mes lexuesit dhe autorit. Duket sikur hapësira e ndërmjetme nuk ka filtra që mund ta shtrembërojnë të vërtetën, ëndrrën apo fantazinë që përcillet përmes faqeve të dorëshkrimit. Lexuesi nuk ka nevojë të pengohet në strukturën e fjalive, Jamarbëri i thotë gjërat ashtu siç janë, për të kaluar më tej në përfytyrimet e tij, ëndrrat, imagjinatën, dëshirat që përcillen lirshëm. Kjo veçori lidhet drejtpërdrejt me mënyrën e të menduarit dhe të përjetuarit. Kjo rrjedhë e pandërprerë krijon ndjesinë e mendimit që ngroh, zgjeron faqen dhe iu jep hapësirë fjalëve që presin të kthehen në përjetim për lexuesin. Të duket sikur je në një tren mendimesh që shndërrohet në një automobil që vozit me shpejtësi në autostradë, për t'u kthyer në fund në një varkë me vela, ku autori të buzëqesh së largu.

“Një ditë të bukur me diell, pasi u zgjova në mëngjes dhe gjithashtu sapo hëngra mëngjesin dhe sapo u vështa dhe sapo bëra gati çantën dhe gjithashtu vura syzet dhe gjithashtu u nisa gati për në shkollë dhe rrugës duke shkuar unë fillova t'i tregoja mamit për ëndrrën që unë isha vetëm në shtëpi dhe ju kishit ikur për të ngrënë

darkë në një restorant dhe duke fjetur gjumë unë sapo isha ngritur nga krevati i marinarit dhe veshja shapkat dhe shkova direkt e në kuzhinë dhe ç'të të shikonin sytë një person që po qëndronte i relaksuar dhe misterioz me flokë të zeza me vetulla të zeza me sy të kafenjtë me qerpikë me veshë me hundë shkabë me mustaqe me këmishë të zezë me rrip në pantallona me pantallona të zeza me çorape të zeza me atlete me orë të zezë në dorë dhe që gjithashtu unë i thashë mamit dhe babit që ishte një gazetar mami u mahnit dhe unë i thashë që ishte gazetari që unë njihja dhe e kisha mik dhe ajo u shkri së qeshuri..."

Në këtë fragment ngjarjet lidhen pas një ëndrre, që kthehet shumë shpejt në rrugë për t'i avitur reales. "Takimi me gazetarin Sebastian Zonja" i ka të gjithë elementet e duhur: mëngjesi, ëndrra, rruga, emocionet, takimi, prezantimi dhe fotografia renditen sipas logjikës së mendjes që i jeton. Ëndrra e bën realitetin dhe realiteti stimulon ëndrra të tjera. Kjo, e thënë me çiltërsi dhe aq natyrshëm, sa të vjen që t'i rikthehesh edhe njëherë leximit. Nuk ka fjali të shkurtra. Mendimi nuk mund të vishet me forcë brenda shenjave të pikësimit. Çdo paragraf është një frymëmarrje e thellë, frymëmarrje e Jamarbërit.

Në vijim, teksti kalon natyrshëm drejt eseve në vargje dhe poezisë. Ky kalim nuk

është drastik, sepse edhe proza mbart impulse poetike. Kemi jetën e ëndrrës, jetën reale, pastaj hapësirën e dashurisë së pakushtëzuar. Familja është gjithçka dhe nëna, babai, vëllai, motra e munguar, gjyshërit, hallat, tezet bartin copëza të autorit, të përcjella me ngrohtësinë dhe sinqeritetin e ndjenjave të mirëfillta. Në këtë kuptim, proza rrjedh si frymëmarrje, ndërsa krijimet në vargje dhe poezitë shfaqen si impulse të përqendruara, si përpjekje për ta përkthyer emocionin në figurë. Kalimi nga proza në varg nuk është i prerë; ai ndodh natyrshëm, sepse edhe rrëfimi mbart impulse poetike që në fillesë.

Lexuesi që i afrohet këtij libri duhet ta bëjë këtë me gatishmërinë për të hyrë në një botë që organizohet ndryshe, ku mendimi rikthehet, zgjatet, ndalet, ku emocioni nuk filtrohet për t'u bërë më i pranueshëm. Ndaj "Nën tingullin e Violës" është një ftesë për të parë më afër, për të dëgjuar më me kujdes, për të kuptuar se pas qetësisë së dukshme mund të fshihet një univers i tërë ndjesish. Kjo është botë e Jamarbërit. Ngjyrat, muzika, imagjinata e tij.

Prof.as.dr. Eris Rusi

TAKIMI ME GAZETARIN SEBASTIAN ZONJA

Një ditë të bukur me diell, pasi u zgjova në mëngjes dhe gjithashtu sapo hëngra mëngjesin dhe sapo u vështa dhe sapo bëra gati çantën dhe gjithashtu vura syzet dhe gjithashtu u nisa gati për në shkollë dhe rrugës duke shkuar unë fillova t'i tregoja mamit për ëndrrën që unë isha vetëm në shtëpi dhe ju kishit ikur për të ngrënë darkë në një restorant dhe duke fjetur gjumë unë sapo isha ngritur nga krevati i marinarit dhe vështa shapkat dhe shkova direkt e në kuzhinë dhe ç'të të shikonin sytë një person që po qëndronte i relaksuar dhe misterioz me flokë të zeza me vetulla të zeza me sy kafenj të qerpikë me veshë me hundë shkabë me mustaqe me këmishë të zezë me rrip në pantallona me pantallona të zeza me çorape të zeza me atlete me orë të zezë në dorë dhe që gjithashtu unë i thashë mamit dhe babit që ishte një gazetar mami u mahnit dhe unë i thashë që ishte gazetari që unë njihja dhe e kisha mik dhe ajo u shkri së qeshuri dhe tha: hë Sebo, dhe gjithashtu pasi arritëm drejt e në shkollë dhe gjithashtu unë sapo mora ëndrrën me vete dhe shkova direkt e në klasë dhe fillova të bëja mësimet dhe

pasi mbarova mësimet fillova orën e pushimit dhe gjithashtu përsëri orën e mësimimit dhe kur mbaruam dhe shkuam për në shtëpi ne para se të shkonim në shtëpi ne filluam të shkonim te TEG-u dhe gjithashtu sapo kur pashë personin tek shkallët elektrike unë sa shkova deri atje së bashku me prindërit e mi babi e preku tek supet dhe i thirri: Sebastian, ai sapo u kthye dhe na pa neve mua më përshëndeti gjithashtu dhe babi dhe ai sapo buzëqeshi dhe gjithashtu pasi dolëm ne nga shkallët dhe gjithashtu unë thosha oh, sa më rreh zemra fort, ai tha: Po ç'është ai llafi hajt m'rreh zemra dhe sa kur dolëm unë shkova me të dhe ai u mbështet tek shpatulla ime dhe kur po ecja së bashku me të ai më prezantoi me kryeredaktorin e MCN TV, z. Leonard Mitro, dhe gjithashtu sapo kur erdhën prindërit e mi ne sapo filluam të bisedonim me të dhe unë fillova ti tregoja për karrierën time dhe gjithashtu dhe i tregova dhe për projektin e televizionit tim dhe gjithashtu ai babit tim i dha numrin e telefonit të tij dhe gjithashtu pasi mbaruam së biseduari ne sapo bëmë një foto dhe gjithashtu ne sa shkuam të bënim pazar dhe gjithashtu dhe e lamë babin të bisedonte me të dhe gjithashtu ai sapo mbaroi punë dhe gjithashtu kur erdhi babi pastaj i tha mamit çun shumë i dashur dhe mami i tha çun shumë i kulturuar dhe gjithashtu pasi mbaruam punë shkuam në shtëpi.

Dhe kështu ishte.

IMAGJINATA PËR SHTËPINË ME PLAN TË HAPUR

Unë po imagjinoj sikur po të ktheheshim mbropa në kohë dhe po të rriteshim përsëri dhe po të kishte shtëpi me plan të hapur do fusnim brenda të gjithë njerëzit aty përveç prindërve të mi dhe do kishin dhe të afërm dhe miq dhe shokë e shoqe dhe aty do të qëndronin gjithmonë dhe nuk do të lëviznin nga vendi dhe do të qëndronin njëherë e përgjithmonë aty dhe nuk do shkonin me asnjë vendi dhe gjithmonë do të rrinin me mua dhe do rrinim e do shikonim televizor do të lexonim do të gatuanim do të flinim do të lexonim do të shkruanim dhe do të dilnim në ballkon dhe nuk do të kishte fare vende ku do të shkonin larg do të kishte dhe pishina dhe pishina do të kishte në ballkon dhe tavolina për të pirë kafe dhe nuk do të shkonim në asnjë lokal dhe do të hanim dhe mëngjes dhe drekë dhe darkë dhe do të ishte një vend i përshtatshëm për të gjithë dhe kështu do të ishte një vend i duhur për çdokënd.

PËRSE IMAGJINOJ SIKUR TË KTHEHESHA
MBRAPA NË KOHË DHE TË Rritesha
PËRSËRI DO TË ISHA MË NDRYSHE SE SA
TANI?

Unë flas me prindërit e mi që po të kthehesha
mbrapa në kohë dhe po të rritesha përsëri nuk
do të kisha më autizëm dhe gjithashtu që po të
ndodhte kjo do të zhdukej obeziteti dhe do të
takoja përsëri gazetarë ashtu siç takoj dhe tani
dhe gjithashtu që po të ndodhte e njëjta gjë dhe
nuk do të isha më i shëndoshë dhe do të isha
elegant dhe kështu do të ishte gjithçka e re dhe
më e bukur.

PËRSHKRIM IMAGJINAR

Përshkruaj në mënyrë imagjinare mikun tim gazetarin Sebastian Zonja.

Sebastian Zonja është një gazetar që po të të duket ty në pamje ai sipas një stili imagjinar mund të jetë i këndshëm pastaj mund të jetë me staturë mesatare dhe më pas mund të jetë me një qëndrim profesional dhe karizmatik ai është i qetë kur flet me njerëzit nuk ka superlativa sepse është i qetë por kur debaton ai shpërthen në disa raste ai gjithashtu është i mençur i zgjuar dhe flet bukur vishet bukur dhe del bukur në foto dhe kur janë festat e fundvitit del dhe me veten kur mban gotën me verë gjatë natës së vitit të ri dhe kur del me kolegët e punës në vendin e tij dhe është perfekt në stilin e veshjes. Ai ka një perfeksion real në lidhje me përshkrimin sepse thuhet që është me flokë të zeza me vetulla të zeza me sy kafenj të qerpikë me veshë me hundë shkabë me mustaqe me këmishë të zezë me rrip në pantallona me pantallona të zeza me çorape të zeza me atlete me orë të zezë në dorë dhe ai vërtetë është sepse ajo pamje është dhe unë e imagjinoj me

vizatim sikur vishet me bluzë të zezë me flamur kanadez që thuhet it's Canadian time dhe me këmishë kafe me xhup vishnje me bluzë të zezë Adidas të hollë me mëngë të shkurtra me kostum vishnje me kostum sportiv të zi me vijë rozë pa kapuç me pallto bezhë me kostum bezhë dhe me kostum blu siç vishet ai përditë dhe duke kaluar në rrugën “Maliq Muço” dhe në rrugën “Dervish Hatixhe” dhe me bluzë për festa krishtlindjesh me vija të bardha dhe të kuqe me figura krishtlindjesh dhe në plazh i veshur me rroba banjo të zeza për meshkuj high style dhe sikur është i sëmurë me temperaturë dhe virozë dhe sikur ka shkuar tek doktori që të vizitohet dhe që tani e kam imagjinuar sikur ai ka shkuar te doktori dhe është sëmurë me temperaturë dhe virozë dhe gazetarja Esiona Konomi që është duke e asistuar atë po i mban dorën në ballin e tij dhe kështu është dhe sipas mendimit tim kolegu që i afrohet më shumë atij është Xhevahir Zhabina sepse ai e ka zgjedhur si kolegun miqësor që gjithmonë takohet në kafe.

PËR ÇFARË E KRIJOVA PROJEKTIN E TELEVISIONIT TIM?

Unë e krijoja projektin e televizionit tim për të krijuar të ardhmen time dhe për të mos e prishur të tërën.

Dhe aty shkrova që një ditë profesor Leonardi thuri një plan që do të më dërgonte tek televizioni që do të bëja emisionin po sikur të kisha thënë me veten time që po të krijoja një televizion gjeneralist të fuqishëm që të ishte rrjet ndërkombëtar si Euronews Al Jazeera CNN etj. dhe do ta quaja AuvernaMon dhe do të ishte televizioni më i ri publik shqiptar në Shqipëri dhe ndërkohë që Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) do ta liçensonte dhe ndërkohë që ky televizioni im do të transmetohej në 7/3/5 qarqe përfshirë Tiranën dhe motoja e tij do të ishte Media mbi Autizmin dhe do të thoshte fuqia e medias së lirë autizmi i pavarur paanshmëria e kudondodhur gazetaria e fuqishme e drejta e informimit dhe që ky televizion do të kishte një gamë të gjerë informimi dhe grile gjigante programacioni dhe shumë shpejt do të ishte pjesë e paketave

DigitAlb dhe Tring dhe gjithashtu kanalet e tij do të ishin 27 UHF dhe frekuenca 578 MHz.

Pastaj unë fillova të ndryshoja imazhin e projektit dhe ta bëja më të bukur kur tregohen edicioni informativ emissionet publiciteti dhe pagat e punonjësve dhe gjithashtu unë fillova të bëja një gjë të bukur por humbi dhe do ta rinis përsëri nga e para.

PËRSHKRIM PËR LIZELIN

Lizeli në vetvete është e bukur, është e pastër dhe pamja e saj tregon fytyrën që ka dhe bukuria e saj është jashtëzakonisht intime dhe ajo në jetën e vet është shumë e zhvilluar njësoj si Luna dhe gjithë shokët dhe shoqet e saj dhe gjithashtu ajo ka një të përbashkët me Lunën njohurinë e gjithë njerëzisë së botës dhe zhvillimin e punës dhe njohurinë me gjithë shokët dhe shoqet e saj dhe gjithashtu ajo bën shumë gjëra të bukura i pëlqen të komunikoj me shokët dhe shoqet dhe të fokusohet në detyrë është shumë e qetë sepse ajo gjithmonë i pranon gjërat pozitive ashtu siç i pranon dhe Luna.

Nga ana tjetër, Luna është e njëjtë me Lizelin por ajo në realitetin e vet ka një gjë më të plotë që është përbashkësia që njeh dashurinë dhe vlerat pozitive ajo gjithmonë është për të njohur gjithë njerëzit e botës dhe për ti ditur të gjithë vlerat e saj dhe kjo është lidhja e përbashkësisë sepse ato të dyja kanë një njohuri të bukur që bota të sjell vlerat më të mira dhe më të dashura dhe gjëja që iu mungon në përbashkësi është

që nuk kanë vend ku të mendojnë e të tregojnë e të bëjnë botë dhe tregon që bota e tyre është kështu siç janë.

Lea ndërkohë për Lunën është metaforikisht si një lule që e vë në majë të kokës dhe tregon që do të duket si një vend për bashkim miqësor të klasës sepse ajo e di mirë që Luna është për të njohur gjithë vlerat e botës dhe të mësoj jetën e zhvillimit të stilit të jetesës së saj, ndërsa për Lizelin është si një shoqe që i duket metaforikisht që i ka bërë përshtypje shumë në kohë të fëmijërisë së saj dhe bota ja ka kapur që ta ngre lart në majë të hirit të punës.

PO TË LIDHJA KUJTIMET E SË
SHKUARËS ME TË TANISHMEN DO
TË ISHTE PERFEKT
(Tregim për Serafinin)

Po të lidhja kujtimet e së shkuarës me të tanishmen do të ishte perfekt.

Sepse po ta bësh një gjë do të duhet ta lidhësh me të parën.

Për mua e para si fanse që më ndihmonte për të takuar njerëz që njihja për të më dërguar në fondacion pastaj për të shkuar në kafe për të pritur në stacion të autobusit që të më dërgonte në kopsht se ajo ishte e mençur shumë dhe e shkolluar me trup të drejt me flokë të kadifenjtë me fjalor dhe kulturë në gojë dhe për të kuptuar që kishte të njëjtën performancë me mamin dhe gjithashtu unë e lidha që shikoja dhe Zef Dedën si të ftuar në produksionet e Profesor Leonardit aty tek ato të klasës së shkollës dhe kështu në mes të tyre u krijua Sebi, shoku im.

Dhe e dyta ishte që njihja kushërirën time të dytë, Lolën, origjinalisht, dhe pastaj unë sapo kisha blerë një top plazhi futbollli në Golem dhe ishte i bukur ngjyrë blu dhe kur u bë me pluhur u vjetërua dhe e mbajta në

ballkon dhe ra vetë duke u hedhur dhe kur mora vesh që babi më tha që nëna e qenit po lindte fëmijën e saj që është këlysh qeni dhe gjithashtu qenin kishte vendosur ta quante si elfi i Harry Potter që është Dobi dhe ishte me racë gjermane Deutsche Kurzhaar (Braak) dhe ishte nga Serbia dhe vinte nga familja serbe e qenve Del Jugoviç dhe unë kur e pashë fillova ta përkëdhelja të luaja dhe të vija te vendi i tij dhe ta merrja me vete kudo dhe kurdo dhe kur dëgjonte të qarën time me dënësë që shtrihesha në divan duke vënë kokën në jastëk ai ia bënte mmmmmhmmmmhmmmmhmmmmhmmmm, dhe ai kur luante dhe më përkëdhelte vdiste dhe mbaronte dhe lehte dhe hapte gojën kur qeshte dhe mbështetej kur shtrihej me mua dhe këtë bënte gjithmonë sepse edhe e merrnim në mal dhe shikonte nganjëherë se si gjuante babi me çifte thëllëzat e malit dhe frikësohej përherë vazhdimisht sepse këtë bënte ai gjithmonë.

Për Serafinin, tregimi bën fjalë që njihet shpesh si prift i fortë por shumë i mençur dhe duhet fort dhe nuk mendohet negativisht sepse dhe vetëm po ta dish ti ka të ngjarë si i njohur shumë dhe nuk ka me kë të afrohet sepse atë e duron kurrkush dhe ai më pyeti se pse e kisha thënë atë fjalën që ishte nuk dënohet një zemër nga gjyqi i lartë sepse një zemër mund të mbajë dashuri dhe unë i thashë që sepse kur flisja me vete do doja të shpërtheja emocionet që t'i

shprehja me fjalë dhe për këtë ai na mikpriti që të vizitonim kishën dhe të shikonim kambanën e kishës se si lëvizte dhe për këtë unë vendosja t'i shkruaja një dedikim për librin tim të parë me 101 poezi Auverna Mon (Lulëkuqja) dhe librin Djaloshi Autik dhe ai kur i pa më falënderoi jashtë mase, dhe m'u duk si Gjergj Fishta në pamjen e tij sepse ngjante me një poet dhe ai më tha dhe unë kam shkruar kur kam qenë në shkollën fillore, prandaj e dua poezinë dhe thoshte qetësi dhe kohë jepi Jamarbërit gjithmonë kohë të flas.

GURI I LIQENIT (OHËR)

Më erdhi një imagjinatë që mua më dukej sikur u kthjem mbrapa në kohë

Dhe mos u krijua gjë liqeni në atë çast, u ngjita te një gur që bëri një buuuumm

Dhe zhurma që bëri ishte uji që me dha ndjesinë e algave, ndjesinë ujore që të kënaq, dhe gjithashtu më erdhi në mendje koha e lashtësisë, para se të krijohet liqeni ku ishte një fushë boshllëku

Dhe e gjitha ndodhi për shkak të gurit nën ujë.

Dhe më rikthehet sikur u zhduk liqeni dhe u bë fushë.

BISEDË MBI BANANEN \$6.2 MILION
PASI NDOQËM BIETA SULO NË FTESË
NË 5 - TOP CHANNEL

Mami: Jamarbër, ç'mendim ke për bananen që u shit \$6.2 milion?

Unë: Kam mendimin që është një banane shumë e çuditshme.

Mami: Ku qëndron çudia?

Unë: Çudia qëndron te shitja e bananes.

Mami: Pse te shitja?

Unë: Sepse kjo është lidhja që krijoi këtë shitjen e bananes \$6.2 milion.

Mami: Ç'lidhje?

Unë: Lidhja që ka të bëj me çmimin.

Mami: Cila është lidhja që ka të bëj me çmimin?

Unë: Lidhja që ka të bëj me çmimin është që është shitur shtrenjtë.

Mami: Pse mendon që e kanë shitur aq shtrenjtë bananen Jamarbër?

Unë: Sepse nuk e blen dot një klient.

Mami: Çdo të thotë nuk e blen dot, ajo është blerë tashmë, që do të thotë që është shitur, por përse ia kanë vënë këtë çmim kaq shtrenjtë?

Unë: Ia kanë vënë sepse ajo duhet të jetë më e shitura e bananeve

PJESËT QENDRORE TË DUKURISË SË
JETËS SIME NË NJË NDJENJË
SHQETËSIMI TË THELLË
(*mendim*)

Ndjenja e shqetësimit të thellë nga një enë e tërësisë së një tërësie të një bashkësie me një tërësi të kallëzuar në një tërësi ku me pengonte në dukurinë e sjelljes së sigurisë së një pëlhure dhe që më vinte qetëshprehësja ime me një zë të fortë nga një veprim tërheqës dhe që me zinte me gojë mjekimin e autizmit dhe që me shprehte me fjalë mungesën e zhurmës së ndjenjës së shqetësimit të thellë nga një enë e tërësisë së një tërësie të një bashkësie.

FAMILJA ËSHTE ZEMRA E SHTËPISË
- DASHURI NË VARGJE -

NËNA

Për mua “Nëna” është që
T’i japësh dashurinë që ia fal gjithë botës
Dhe ta dëgjosh mirë kur të jep një këshillë
Ndihmën t’ia pranosh me respekt
Sepse dashuria e saj është pa kufij
Asnjë lëndim dhe përdhunim nuk i jepet
Gjithmonë mbahet në zemër
Ajo është mençuria e shpirtit
Kjo është nëna
Nuk ka si ajo në botë
Është unike
E paparë
Asnjëherë nuk krahasohet me dikë
Vetëm atë e puth në faqe dhe e përqafton
gjithmonë
Kurrë nuk braktiset përjetë
Pranë saj unë qëndroj
Në jetën time kurrë nuk jam shmangur
Jeta e saj është e vëmendshme ndaj punës
Larg shpërqendrimit jeton
Bota e saj është një shpirt dhe një dritë
Jo të qëndrosh larg saj se nuk të vret
Harresat nuk ekzistojnë tek ajo

Aty ka dijeni histori art dhe kulturë
Këngëzimi i saj bëhet si zëri i bilbilit në pyll
Dhe nxehtësia e saj nuk e merr në mend
intonacionin e zërit
Buzëqeshja ia shton harmoninë
Vetmia dhe trishtimi ndodh kur i thyhet
zemra
Gjërat nuk i merr nëpër mend kur njeh botën
Sepse ajo thotë që do t'i lemë këto
Se duam të shijojmë natyrën dhe të
fokusohe mi në detyrë
Asaj i vjen jeta dhe për gjumë
Dhe thotë: “Fli mam, fli, se nuk ndodh
asgjë!”
Gjithçka thotë që ecim përpara
Nuk ka kurrë kthim mbrapa
Gënjeshtër nuk mbizotëron
Vetëm të vërtetën do të thuash
Nëna e ka zërin të bukur të ëmbël dhe jo të
ftohtë
Aty mbahet zemra e ngrohtë dhe jo ulërime
e pyllit
Flladi i erës të vjen në zemër
Mosbesimi është i zhdukur
Shpërthimi është i natyrshëm
Se kërkon leximin e dijes së madhe
Gjatë jeton një nënë
Nuk humbet kurrë në jetë
“Të dua shumë” është përgjigja e fjalës
Je natyra e botës sime

Asnjë krijesë nuk krahasohet me ty
Se je një yll i bukur
Dhe nuk zhduket përkohësisht
Mbetet përjetësisht
Aty ngelesh përjetë
Dhe kur të rritem dashuria do të ngelet në
parajsë
Zbulim në zemër nuk ka
“Je një dashuri” kjo është fjala e fundit e
buzëqeshjes
Të dua shuuuuuuuuuumë!

BABI

Për mua “Babi” do të thotë
Dashuria e dytë e vëmendjes në punë
Dhe mos u mendo ndaj tij kur punon sepse
ti e bezdis rëndë
Me asgjë tjetër nuk ndërhyhet se ai është
fjalëdashës
Nuk i merret ndërmend kurrë sjellja e keqe
dhe përbuzja
Ai këmbëngul të guxoj e të kërkoj në disa
raste
Sepse gjithçka për të është vlera e jetës!
Këshillat nuk i sillen si lavjerrës
Mendimtaria është një punë e fortë
Pasioni i zemrës së tij është magjia e maleve
Besa e shqiptarit ja ka zbutur çapkënesinë!
Bota e tij është e fortë dhe autoritare!
Nuk e zhduk askush atë se edhe ai ka një gjë
të mirë.
Jo të lesh punën mënjane e të bësh si vetja
në zemër të fortë
Por fokus dhe vëmendje jo nerv dhe dhunë
Dashuri dhe mrekulli
Dashamirësi dhe jetë!
Kjo është një rritje e re!

VËLLAI

Për mua “Vëllai” do të thotë
Dielli dhe jeta lozonjare dhe mendja e
ndritur
Por ai është shakator në disa raste
Se dhe humori ia lodron buzëqeshjen
Dhe nuk ka botë që të të ngacmojë
Sepse shakatë ja kënaqin shpirtin
Por “scrolling-u” për të ahhh se ç’është një
gjë
Nuk lodhet kurrë me telefon e laptop
Librin e kap se i vjen mendja vetë
Qan nganjëherë për detyra se nuk i hahet
truri fort
S’ke ç’t’i bësh do të piqet dhe ai
Të gjithë njerëzit kështu e kanë!

MOTRA (E MUNGUAR)

Për mua “Motra e munguar” do të thotë
Ah sikur të ishim 3 fëmijë
e të bëheshim 5 veta
Do të ishte dhe hallë për fëmijët e mi
S’do të ma ndante botën me forcë
Ajo do të ishte dhe vajzë e re
Se kështu është rinia me pleqërinë
Por po të mësosh shumë e më shumë
Unë do ta ndihmoja dhe në detyra
Edhe po të bëhej në të ardhmen gazetarë
Do të ishte kolege me mua
Kjo është ëndrra magjike në imagjinatën
time!

GJYSHI

Për mua “Gjyshi” do të thotë
Dashuria e pleqërisë së ngushtë
Se nervi nuk shkon në jetë
Bota është buzëqeshje e ngrohtë
Zemra duhet të rrahë fort siç është stina e
Vitit të Ri
Gjithkush na ka xhan në jetë
Nuk rrihemi me njëri-tjetrin
Duhemi fort me respekt dhe mençuri
Këshillat janë të pakta
Por ushtria është një humor
Vera ikën e vjen dhe qejfi na mbin gjithmonë
Askush nuk na mërzit
Ecim përpara dhe vdekja na mbin
Kështu është gjyshi i mirë!

GJYSHJA

Për mua “Gjyshja” do të thotë
Dashuria delikate e mençurisë
Tregimi i historisë së bukur
Dhe moskujtesa e disa gjërave që nuk i
duron
Forca e dashurisë ka të bëjë lidhje me
pastërtinë e mendjes
Që është mençuria që vete e ndrin ajo me
respektin dhe vlerat pozitive
Bota e gjyshes është kuzhina e madhe që
pranon tezja e bukur
Dhe ëmbëlsia e saj në gojë sjell vetëm fjalë
të mira
Tregon dhe humoret e problemeve të gjyshit
Që pikës t’i biesh aty dhe nuk ke ku t’i
dalësh
Dhe është një përshëndetje nga larg
Ku flasim bashkë për gjërat e bukura dhe
përshëndetemi bashkë në zemër
Kjo është gjyshja e mençur!

HALLA

Për mua hallat janë
Bota që më sollën dashurinë e shumtë
Sepse ato janë më bujare
se kurrë në botë
Ato kanë shumë punë dhe besueshmëri
Krahas tezeve dhe xhaxhallarëve shihen që
janë njësoj me botën e një vendi të ndritur
Dhe kur vijnë në shtëpi kërkojnë përqaftimin
dhe puthjen e ëmbël
Njëra sjell magjinë e këngëve dhe operate
dhe kërcimit
Jeta më e bukur është kur kujton fëmijërinë
Se të sjell shëtitjen me hallën e tretë që njeh
rininë
Dhe të katërtën që sjell edukimin e
çrregullimit
Dhe të pestën që sjell artin
Dhe të parën që sjell gjithë të mirat e botës!
Të dytën që të përqafton e të sjell humorin
në gojë
Gjithçka e bukur e mençur e pastër e mirë
dhe e ëmbël e vyer
e këndshme dhe mendjendritur dhe admiron
çdo gjë

Pasi hallat janë më punëtoret dhe më të
qëndrueshmet
Këto janë hallat e ditura dhe shakatore!

TEZE MENÇURIA

Tezja që nuk ofendon
Por vetëm sjell fjalë të mira
Dhe nuk përbuz
Ajo vetëm përqafon dhe mendon
Kështu është mendja e tezes së mençur
Vëmendja ndaj punës dhe biseda mes të
tjerëve.

GJALLESAT E KËSAJ BOTE DHE
OBJEKTET RRETH SAJ

QENTË

Për mua qentë janë
Gjallesa lozonjare si beba të vegjël
Dhe nuk kanë ku të të hanë
Ata lozin me këmbë
Ushqehen dhe me bukë se nuk kanë ku e
mbajnë urinë
Kur shëtisin ato dalin në natyrë dhe në plazh
dhe në mal
Hutimi i tyre është i çuditshëm se njeri nuk
i futet shumë në vend
Se është i vogël njeri dhe gërric e ngacmon
këdo
Njërit i thuhet keq ashtu kur dikush gabon
Dhe nuk i mendohen si në fjalë të tëra
Për gjah qentë kanë frikë se qajnë
Por zihen dhe me të tjerë,
Macet duan t'i kapin mënjanë se duan t'i
ndjekin kudo
Por gjithkush nuk i le se kur del për gjah
njëri
Nuk i paraqendrohet stili të thëllëzës
Dhe leh si t'i pëlqejë

Por malit i ngjiten përpjetë dhe hop i dalin
përpara
Ata respektojnë dashurinë me qentë femra
Dhe vuajnë se duan fëmijë
Këto punë kanë qentë se s'ke çfarë ju bën!

TABELA

Për mua tabela ka qenë një njohuri se kush e
prishi e kush e mbrojti
Sepse ashtu dihet vetë ajo
Realisht çdo gjë është dhe e rregullt dhe e
çrregullt
Kjo tregon që nuk lihet mbas dore
Duhet vëmendje dhe punë ndaj detajeve
Dhe kujdes të veçantë që të mos shkarravitet
Që ajo të jetë e bukur dhe perfekte
Çdo gjë është e pastër dhe intime
Kur bëhet një punë zhvillohet më shumë
Një billboard që përshkron për reklamat
Duhet të jetë stil perfekt
Dhe jo dosido
Dhe ajo na informon të njohim reklamat pa
i parë dhe pa i përmendur
Kështu duhet të jenë tabelat!

TELEFONI

Për mua “Telefoni” do të thotë mbajtja dhe mungesa e tij në kusht të përdorimit.

Dhe për këtë unë kërkoja të flisja në telefon me njerëz të ndryshëm si të afërm njerëz që njoh dhe gjithashtu dhe kur më thoshin prindërit: Jamarbër, stop telefonit si ka thënë Silvi, dhe pastaj tregonin që gjithashtu kishte plot njerëz të dashur që kishin telefon dhe flisja kudo pa mbarim nuk përdorja askënd këto ishin se nuk kishin seç bënin dhe unë pasi gjatë e gjerë kur isha sëmure kisha marrë vesh që daja më solli një telefon dhe pastaj unë mora dhe numrin dhe pastaj regjistrova gjithë numrat merrja këdo flisja me këdo dhe pastaj ndodhi dhe një incident që m’u thye pa dashje dhe m’u rregullua por më vonë me babin vendosëm ta çonim tek Etronic që ta rregullonim dhe e lanë në karikim dhe pastaj Xhaxhi Toni një shoku i babit e çoi te mekaniku dhe e rregulloi i vuri dhe një kasë të zezë klasike dhe pastaj i vumë dhe kartën Sim te Vodafoni dhe m’u regjistrua numri im dhe pastaj unë dola të bëja dhe foto të merrja dhe njerëz që njoh të regjistroja dhe

numra dhe i ndërrova dhe kasën dhe ia vura
të kuqe dhe tani që vazhdoj ta kem e kam të
ndryshuar sepse tani e kam të madh kam edhe
kasë të kuqe akoma dhe sepse duket e bukur.

DËGJOJE ZEMRËN TËNDE: AJO I NJEH
TË GJITHA GJËRAT
(PAULO COELHO)

VIOLA

Për mua “Viola” do të thotë “Zemra lejla,
zemra e madhëruar”

Sepse ajo vetë është e tillë sepse ka lidhje
me dashurinë e bukur dhe intime

Ajo gjithmonë e ndjen harmoninë që ka dhe
bota e saj është e fuqishme dhe nuk është e
varfër

Kjo do të thotë pasuri e pasionit të artë
dhe shkëlqen në dritë të diellit.

Dhe ajo shkon lart dhe është e madhe e
bukur dhe e pastër.

Nuk fshihet kurrkund si gënjeshtër ajo
shfaqet si e vërtetë

Por vetëm do të bëjë të vetëm dhe e fortë si
zemra e madhe është për librin e parë

Sepse “Viola” është e artë dhe e shkëlqyer
dhe e do fort artin dhe shkrimin dhe leximin
“Viola ngrihu lart dhe përpara ec bëhu e
artë” ky është mesazhi

E preferon leximin dhe vëmendja e saj është
si një falje e dashurisë

Nuk është trishtim por gëzim dhe lumturi.

Të jesh si ajo do të thotë: “Magji, eksperiencë,
jetë, dritë e diellit”.

As nuk vuan ditën dhe natën dhe nuk harron
kurrë në jetën e saj.

Vetja e saj është e fuqishme dhe e bukur si
gjithçka që preferohet.

Duhet fort me çdo kusht dhe nuk vajton
kurrë.

Ajo është “Viola”

Sepse quhet si frëngjisht “Violet”

Dhe tregon që mua më pëlqen sepse është
luksi i dijes

Ajo i kap të gjithë vlerat pozitive dhe
mendimtare sepse ajo është artistike jo
vulgare.

POEZIA ËSHTË FRYMËMARRJE E
SHPIRTIT

EMOCIONET

Emocionet
Japin botën
Imagjinatën
Sikur rreh tokën
Ti vetë
E kujton lehtë
Kur mendja bëhet lumë
Dhe nuk rrëmben më shumë
Dashuria me dy linja
Në jetën pa thinja
Si bota me gota
Kur toka ka dy koka
Atje nuk ndalet
Se toka nuk matet
Hapet dera
Sikur vjen vera
Je dashuria
Në krahët e mia
Të përqafoj
Që të lulëzoj
Mendja në valë
Është thjesht një fjalë
Fjalëmençuria

Është liria e jetëve të mia
Bota e lirë
Si media e mirë
Aty ku miqtë
Janë të dyfishtë
Dhe një emër
Është si një letër
Aty është pak a shumë si merkato
Por edhe radio
Është si një pallto
Vetëm miku yt metaforikisht
Është profesionalisht
Jo një mbështetje në shpatull
Por si një orakull
I njohur si një mango
Por është edhe si një audio!

DO TË TË DUA NË FUND TË JETËS

Do të të të dua në fund të jetës
Sepse ti ke vlerë një mijë herë
Ty nuk të hahet truri dyfish
Se ti je nëna ime
Këtu mbete përjetë
Dhe vetë ti nuk vuan kurrë

MA KE DRIDHUR ZEMRËN

Ti ma drodhe zemrën
Sepse ti vlen përgjithmonë
Dhe jeta kapet dyfish
Shikimi është një e ngjarë
Që më emocionon
Dhe shpirtin ma gëzon!

GAZETARËT NË PAMJE JANË SI INSEKTE

Gazetarët në pamje janë si insekte
Sepse ashtu janë dhe kur shikojnë
Dhe vetë po të panë ata sy me sy
Gjithçka ti ndjen
Dhe vetja jote vlen
Bota të shkon lart
Dhe hapin nuk e ndal
Dhe lumturia ndjehet dhe serioziteti merret
Kjo është bota e tyre në metafora të
ndërthurura...

BUZËQESHJA NË VETVETE

Buzëqeshja në vetvete
Është kur të hipin emocionet e muzikës dhe
i dëgjon vesh më vesh
Dhe dashuria kap mat çdo gjë të keqe
Dhe nxirret në imagjinatë të fortë dhe hapet
më dysht
Gjithçka bëhet zemër e fortë
Me thellësi të madhe.

NË GREMINËN E THELLËSISË

Në greminën e thellësisë
Është vetëm vetja që të kap
Po i pafokusuari nuk të kupton
Se bota vet të thërrmon
Kotësia ta ngre veten
Dhe bota s'e gjen mendjen
Vetvetja lind trurin
Emocionet nxjerrin lumin e ndjenjave të mia
Dhe gjithçka vjen nga fjalët e mia.

SYRI I DIELLIT

Re të verdhosura
Ka në qiell
Duken gjatë mëngjesit afër njëkohësisht
Dhe bukur dita nis
Me diell të ndriçuar
Syri i diellit i verdhosi retë porsa shkrep
mëngjesi
Shfaqen në qiellin e vranësuar
Kapen dysh me njëra tjetrën dhe nuk ndahen
Përhimen me trupin e tyre.

VJESHTËN E KA MBYTUR
PIKU I VERËS

Vjeshtën e ka mbytur pak piku i verës
Sepse dalin ato bishtfashistët e poshtra
Që vetëm dinë të hanë dhe të ndyjnë
Ashtu dhe vetë do ta kuptoja
Vetëm bishtfashistët sillen ashtu.

HUQËRIT E TMERRSHËM

Këto huqërit e tmerrshëm
Janë një mijë të zeza
Që po më shkaktojnë ca të kafshuara
Dhe nuk më lenë fare të ndihem i lumtur
Por më sjellin lemeri
Dhe më kafshojnë tek vetvetja
Bëhet tmerri.

EKLIPSI HYJNOR

Eklipsi hyjnor
janë heronjtë e mi
Ata dinë kujdesin
mirë me punë të lirë
Dhe botët kanë maturi
Askush nuk është dosido gjithmonë
Vetëm mençuria vlen sa jeta
Me fat që prindër kështu kam
Dhe janë punëtorë e mençurues të jetës.

MOS JANË MËRZITUR NJERËZIT VALLË (MENDIM AUTIK)

Mos janë mërzitur njerëzit vallë
Jo nuk shoh asnjë
Çdokush ka veprimtarinë e dobishme të tij
Dhe nuk bëhesh ndërmjetës te tjetri
S'ka pjesëtar të shoqërisë njerëzore që të
mërzitet
Se puna të thotë mos u mërzit
Vëmendja sjell çdo gjë që bën
Asgjë nuk ndodh
Çdo gjë që nuk bëhet përherë si mërzia nuk
ndodh
Të gjithë e dinë që njeriu nuk është lule mos
më prek me tjetrin.

SYTË QË FLASIN

Sytë që flasin në qiell
Janë të trishtuar pa diell
Fëmijët në luftë vuajnë
Sepse ata vetë nuk luajnë
Trishtimi është si shkretëtirë
As jeta aty nuk është e lirë
Por dëbimi ishte mizor
Se i ligu bënte terror
As qielli nuk ka re
Dhe kaltërsia nuk e njeh.
Mendja e së keqes nuk të flet.
Por vetëm në heshtje të vret.

NGRIJE LART ADOLESHENCËN

Ngrije lart adoleshencën
Që ta ndjesh jo si me demencën
Por ta afrosh me forcë
Sepse ti e lidh si kockë
Bota është e luftuar
Se mendja nuk është e shuar
Askush nuk e mundon
Dhe gjithkush e përjeton...

SHPËRTHIMI I ZEMRËS

Kur takoj kryqëzimin tim
Duket tamam sikur shoh disa gra
Që ndërrojnë rroba të nderura
me ngjyra të ndryshme
dhe që i bëjnë të bukura.
E ndjej këtë gjë se më vjen sikur gratë vishen
me rroba të ndryshme
si të kuqe, blu, të verdha, kafe, gri, rozë,
portokalli, turkuaz, vjollcë, e artë, e
argjendtë,
Dhe më shprehin zemrën e madhe të jetës
Zemra e madhe e jetës është tek imagjinata
sikur shoh dashurinë time të veshur me
bluzë të hollë, me mëngë të shkurtra dhe
me flamur kanadez ku shkruhet: “it’s your
Canadian time”.
Vjen ndjenja sikur sheh disa ushqime të
përgatitura bukur,
Dhe jep pamjen e ngjyrave të ylberit,
Ngjyra e ylberit më zgjon fillimin e
mëngjesit,
Fillimi i mëngjesit është mirësia dhe
mençuria,

Buron nga lumturia dhe dashuria,
Dhe derdhen tek mikpritja e ngrohtë dhe
zhduken të zezat.
Rrjedha të çon tek vlerat pozitive dhe aty
përfundon përjetë.

DIMANERA
(*botërisht*)

Poliqitikani,
poliqtikadiris.
Sanadmo dinam timano.
Mendërisht,
përfundimisht lart,
përkohësisht.
Më lumturoi
zgjimi
i mëngjesit.
Jeta ime
e arriti
ditën e lumturisë.

SHKËLQIMI I DIELLIT

Shkëlqimi i diellit në një ditë me re në
emocion
Shfaqet papritmas me tingujt e muzikës
Tingujt dëgjoen vesh më vesh
Dashuria kap mat çdo gjë të keqe
Ajo i nxjerr me imagjinatë të fortë dhe hapet
më dysh
Gjithçka bëhet zjarr
Emocioni çlirohet.

GJITHÇKA SI EMOCIONI

Gjithçka në të vërtetë është si emocioni
Sepse ashtu duket dhe kur shikon
Dhe vetë po të panë ata sy më sy
Gjithçka ti ndjen në shpresën tënde
Dhe shpresa jote vlen
Bota ty të shkon më lart
Dhe hapin kurrë nuk e ndal
Gjithmonë lumturia ndjehet dhe serioziteti
çdo ditë merret
Kjo është bota e emocionit në metafora të
ndërthurura

F KOKULUR

Duket si forma e zanores së dytë
E që mbyllet dy herë në fazën e vetës
Duket një variant forme
Ajo vetë gjithmonë është
Percepton qejfin që të bën shumë përshtypje
ty dhe të ndjen më fort
Si vetja që është ajo vetë e ka botën të ndritur
dhe luan më fort

V ME NJË SY

Duket si forma e zanores së parë
A që ndriçon në pabesinë e thjesht për
shkronjat në vetveten e botës
Duket “under a mountain”
Ajo vetë është
Percepton ëndrrën që bën është vetë bota me
jetë të bëra dhe ashtu vetë mund të duket
Si në pamje ashtu vetë mund të jetë dhe
është “a beauty in a out of believing for the
letters in the world of herself”

DASHURIA NË ZEMRËN E GJOKSIT

Dashuria në zemrën e gjoksit
Ndhmon rritjen dhe botën e njerëzve
Sa një mijë net do të shpikësh gjëra në
fëmijëri
Dhe realiteti bëhet wow
Jetën nuk ta ndryshon kurrkush
Vetë ti je drita që të kam
Me fat që ti s'lë vetëm njeri
Dhe ti je një thesar i artë me plot para!

FORCA E PARË E DASHURISË

Forca e parë e dashurisë
ti vetë je se bota quhesh
Dhe të gjithë të japin shpresë
Fort dashuri dhe fort lumturi
Jetë të bukur dhe të gjatë të sjellshin
Me heronjtë e tu
Lum si drita që të kam
Lum si zelli që të njeh
Lum si syri që të shkëlqen
Lum si hëna që të ka rrit
Dita e diturisë përpara të shpjerë
Mbrapa kurrë mos mendofsh
I fortë qofsh përherë
Sa malet na rrofsh!

VENDI I MBYLLJES

(mbyllje)

Jeta e botës do të më dërgojë deri në fazën
përfundimtare të ditës sime,
Dhe aty unë do t'i nxjerr fundin punës,
Dhe do të mbyllet gjithçka deri në zemër,
Dhe do të më shpjerë te bota që bie në fund
të mendjes sime,
Dhe do të ekzistojnë emocionet e mia në
vendin e jetës së botës.

CLOSURE

(poem by me)

No more street,
No more work,
Only, only fallimented
Lonely Death.
No more voice,
Only music in quietly,
Only choking,
Choked to death,
Into the paint black,
Imaginations who a person is making a
diving swimming,
Like Gigi Hadid in the song “How Deep is
Your Love”.
And its the last recooperation,
Only yourself,
No more!

EMOCIONI I ZEMRËS MË MBIU NË MAJË TË SYRIT

Të rrish afër emocionit të zemrës,
është sikur të jetosh në botën e tij,
Dhe ta përjetosh atë,
Sikur duket gjithçka natyrale,
Përballë me godina dhe me vende të
natyrshme,
Si plot dritë dhe mençuri,
Dhe ta ndiesh atë sikur të të buzëqesh,
Të të vijë normale dhe ngjyrat vijnë aty dhe
lidhen në ndarje si: e kuqe, e verdhë,
blu, vjollcë, e gjelbër, rozë, e zezë, e bardhë,
kafe, gri, e artë, bezhë, etj.
Dhe japin zemrën e madhe të natyrës,
Me lule te bukura që të përqafojnë shumë
dhe janë të dashura shumë
Në kuptimin dhe zgjedhjen,
Dhe duket e përzemërt
Dhe ta ndiesh në gjoks të hapur!
Ohhh!...

MUSHKONJA BISHTFASHISTE

Mushkonjë bishtfashiste,
Je vetë ti që më mbyt,
më mbyt me dashurinë e forcës,
Sepse ti vetëm do një ngrohtësi lozonjare,
Dhe tek unë vjen si një gudulisje që të bezdis
pak.
Kam ndjesinë e largimit,
Nuk afrohem shumë që të mos ngjitem.
Dhe me ulëret ndjenja sikur kam atë botën
me plot probleme të vogla që nuk arrijnë të
afrohen tek zemra dhe qëndrojnë mbyllur në
largimin e ndjenjës së falimentuar.
Vrulli i ndjenjave të tua mban atë forcën që
të bën gjak.

E DALA NË PËRHAPJE

Mbaje kokën lart, më shiko këtu në sy.
Vallëzo me emocionet e tua,
Mbaje në mendje personazhet,
Shiko kush të imiton, kush të shikon,
Kush të çudit dhe nuk të ndalon.
Kush nuk të është bërë e mirë,
Në të tallur e të gdhirë.
Kush të shikon në fije të dritës
duke bërë një punë të zënë.
Dikush të thotë: - Kush do grua?
Ti i thua: - Gruan do ta gjej vetë,
do ta mendoj vetë.
Kur ti del në ballkon,
Të merr imitimi dhe qeshja të arkitekturon.
Dikush të shan dhe dikush thotë: “Gruaja
më pëlqen të jetë fjalëmbël”
Të mos qëndrosh në vendin tënd aty të
thonë:
“1,1 e gjysmë 2,2 e gjysmë,
3,3 e gjysmë, 4,4 e gjysmë,
5,5 e gjysmë, 6,6 e gjysmë,
7,7 e gjysmë, 8,8 e gjysmë,
9,9 e gjysmë, 10,10 e gjysmë,

11,11 e gjysmë, 12,12 e gjysmë,
13,13 e gjysmë, 14,14 e gjysmë,
15,15 e gjysmë 16,16 e gjysmë,
17,17 e gjysmë, 18,18 e gjysmë,
19,19 e gjysmë, 20,20 e gjysmë”

kështu ta bëjnë dhe kur dëgjon muzikën në telefon, të thonë ti ia bën “Fërrr-fërrr-fërrr-e-fërrr-e-ta-fërrr-e-ta-fërrr”,

dhe të gjithë tallen me ty dhe të thonë “mos e dëgjo çfarë thotë koka jote, por bëj si bota jote”.

Mos thuaj “Bonjour Mon Amour” se do të qeshë e gjithë bota.

Kështu është e thëna “në të sajën” që ta mban më fort kupën e kokës.

FRIKA E GABUAR E GËNJESHTRËS
(mendim mbi gjendjen time)

...

Mos gjaku im po kthehet në një trombocit?
Kjo është pyetja që bëj kur më shprehet
ankthi.

Mos po më kthehet truri im i vogël në një
granulë?

Kjo është pyetja e dytë që bëj kur më
shprehet përsëri ankthi.

Mos po më kthehet muskuli im në një
miocit?

Kjo është pyetja e tretë që bëj kur më
shprehet përsëri, e përsëri ankthi.

Këto pyetje i bëj që të shpreh ankthin tim.
Ankthi më shkaktohet prej zhurmave në
trup,

Sepse veten e kam në ankth të hapur.

Ankthi i hapur është frika e gabuar ndaj
zvogëlimit.

Se e tregon gënjeshtra,

E buka e ndenjur lëshon erë të egër,

Ankthi ngrihet e shkon në majë të trurit,

Lëshon fjalët e ulëritura me frikë,

Liliput apo Gjigant?

* * *

Ndjenja shpirtërore
që më mban në gjoks
ka ditën e ardhjes në jetë.
Ajo më duket si e ashpër me të egër
Me një luaneshë të egërsuar në zemër,
Me një gjemb të frikësuar në kokë
Rend prej pasqyrës vrasëse
gjithashtu edhe prej ankthit të tmerruar.

RRJETET E NDJENJAVE TË KOTËSISË (mendim)

Periudhat e shkronjave të mia simbolizojnë
fjalët dhe frymëzimet e luftërave të tyre dhe
gjithashtu sigurojnë ndjenjat si era e
fërfëlluar dhe gjithashtu edhe sjellin ngrirjen
e ngacmuar dhe rënien e ulur të
papërfitueshme.

E para sjell trishtim dhe relaks.

E dyta sjell gjithë në rritje të gjitha gjërat.

E treta sjell dije dhe mosdashje të ngacmuar.

E katërta sjell multi-jetë.

E pesta sjell të njëjtat me të katërtën.

E gjashta sjell dashuri dhe adhurim dhe
negativitet me dashuri të egër

E shtata sjell një lehtësi të ndjeshme me një
rënie të fuqishme.

E teta sjell kujtime dhe dështime dhe çlirime.

E nënta më sjell veçanti por e teta e ngacmon
atë.

LINDJE-PERËNDIM

(mendim autik)

Lindja imagjinon jetën dhe perëndimi
imagjinon qetësinë.

Lindja jep dashurinë e fortë e të lumtur,
kurse perëndimi jep dashurinë e fortë të
jetës dhe qetësisë.

SHPIRTI QË S'M'U PËRSHTAT

O Zot, ma hiq të keqen,
Se po më vjen mallkimi i jashtëm
Ai shpirtkeqi më shkuli gojën
Dhe më dëmtoi e më hodhi në ujë të helmuar
Si guxoi të ndodhte kjo
Ah, mos m'u ktheftë e keqja e gjallë
Qysh në periudhat e shkronjave që zgjidhja
isha në të qenët
por në periudhën e 7-të isha si një fëmijë
Tani në periudhën e 8-të jam si një adoleshent
i vërtetë
Dhe shpirti i zi më këputi
Më zjeu të tërin në flakë
Dhe ma prishi rregullin e bukur
Ah, të lutem, më hiq ujin e zi!

VJESHTA MES DIMRIT

Vjeshta mes dimrit
Janë të ndara në dysh.
Kur njëra jep shpresë,
dhe tjetra e përkëdhel
me të ftohtin e saj.
Si dy zemra bashkë
Nuk janë të ndara kurrë
Dhe pozitivitet çmojnë,
Me plot pasion,
Me shumë ëmbëlsi
Kanë jetën e së ardhmes,
Ku mblidhen realitetet e mëdha.
Me plot kuptim
Janë si kodra me gjethe dhe mali me borë,
Të dy nuk marrin të zezat e së keqes,
Por të dy përjetojnë bardhësinë pozitive.

USHTARJA E FËMIJËRISË

(kujtimet nga fëmijëria)

Ushtarja e qasjes edukative,
Me ushtrim force të rreptë,
Donte që ne të ishim përherë,
Si burra trima lufte.
Me këmbëngulje ajo përsëriste,
Me zërin e saj të lartë,
Ushtrimet dhe vjershat,
Që flisnin për shkronjat,
Për të gjitha kafshët,
Shpendët,
Numrat.
Me të njëjtin zë ajo thoshte,
Urdhra të zgjatur rreptësisht,
Që përçonin seriozitet shoqëror,
Dhe çudi shakatore.

HIJE TË ZEZA

Hije të zeza më janë bërë kundër
një miratimi pozitiv.
Ato u lidhën me një dredhë që i përkiste
ngjarjeve nga jeta.
Me disa pjesë të pazbuluara që më sollën
zemërimin e fortë,
Që më bëri një gjendje të shndërrueshme,
të kundërshtueshme,
Këto ishin hije të zeza që më pështjelluan
ndjenjat.

KRYQËZIMI

(poezi-takim emocional)

Kryqëzimi mes një brezi
me një tjetër brez të rrahur, a të shtruar
Duket si një zhytje në një rrjedhë
Që i lë udhë emocioneve të mia.
Në zemër të rrahur të shpërthej
prej shpirtit të emocionuar.

KOHË PA KOHË

Kisha kohë pa i zbardhur prekjet
Kisha kohë pa i zbardhur nuhatjet,
frymëmarrjen
Kisha kohë pa u shprehur i lirë
Kisha kohë pa krijuar një melodi
Kisha kohë pa u kujtuar për çdo gjë
Kisha kohë pa bërë shaka
Kisha kohë pa kohë dhe kisha humbëluar
në ngrirjen e thellë...

* * *

I frymëzuar nga vetja
me buzëqeshjen time,
Për shkak të thumbimit të lehtë,
Në qendrën e të të menduarit,
Më vjen një sjellje e njerëzishme,
Dhe unë them që të mos e dëgjoj më atë
fjalë.
Kjo është porosi e fazës së pjekurisë!

DASHURIA E MALEVE
(poezi sipas një thënie të vjetër)

Malet qëndrojnë mbi fushat.
Dhe ata kanë rënë në dashuri me to.
Veç kërkojnë këto kashtat e erës, shelgjet,
thundrakët, burimet e harmonive.
Me lëvizjet ritmike rrahin ajrin,
Dhe ajri kërcen me vrull në drejtim të saj
Duke e fladitur me freski.

PËRSIATJE NË COD

I nxitur nga kodi i filozofisë,
Dhe nga një buzëqeshje e artë,
Që më përshëndeste me një mikpritje të
dashur,
Parajsa e tretë më përfytyrohej
në një pasqyrë të madhe,
Nga reflektohej universi i artit,
Buzëqeshja e ëmbël më reflektonte
ngrohtësinë e saj pozitive,
Dhe shkëlqimin e syve
Dhe zemra më rrihte fort.

GUXIMTAR

Mbresat që më la pritja
Më përcjellin njoftimin e kohës,
Në një dhomë të madhe.
Shumë e madhe ishte ajo vetë
Me një luks gjigant,
Që më përcolli qëndrimin,
serioz të mënyrës,
Dhe një guximtar m'u afrua
dhe më mirënjohu
Në mënyrë të njëjtë
Për shkak të ëndrrës tënde
Që deshe ta ktheje në realitet
Dhe ëndrra e madhe
Ishte vlera gjigante pozitive
E energjisë tënde.

MANAFERRA

Tingujt e poezisë më përfytyronin
Shijen e ëmbël dhe të hidhur
Të bashkuara në një kokërr të vogël.

...

Krejt e vogël është ajo vetë
Me një shije të freskët
që më përcolli shpirtin e madh të poezisë.

LAURETËS

Me lumturi të plotë,
M'u shfaq si trëndafil i bardhë,
I mbirë nga përqafimi i madh,
Përqafim prej syve të saj.
E me buzëqeshje përqafova i lumtur dhe
unë,
Dhe u ngjallën emocionet e forta tek shpirti
im.

LINDUR MES JUSH

Fjalët e moçme më dërgojnë,
mes teje dhe rrënjëve tona.
Dhe kënaqësia e fjalëve më mbështjell,
Dhe krenaria e gjakut më frymëzon,
Dhe në shpirt më lartëson.
E shkuara, e tashmja, e ardhmja,
mes njëra tjetrës më përqafojnë.

*(Kushtuar time mëje dhe fjalëve të nan'dajës
së saj)*

Tiranë, më 22 Maj 2024

ZGJIMI I ZEMRËS

T'i ka krehur flokët era,
Me të kapura të arta.
E lëkundur më dukesh,
Me flokë të shpupuritura.
Mendimi më vjen
Prej frymëmarrjes time.
Prej mirësisë,
Që më zgjon flokartën,
Flokartën, që ma zgjon në zemër.
Dhe në mendje zemrës i zgjohej për një
poezi.

JON

(poezi për kushëririn tonë të ri)

JON, fryma e dashurisë së re,
Erdhi në jetë si një udhëtim,
E vështrova në sy si një anije në det e
mbështjellë nga kaltërsia,
Udhëtimi erdhi si një superfuqi, me valët e
detit që vijnë drejt dhe të mbështjellin, JON.

MES NJERËZVE DHE RRUGËVE
(mendim)

Po të imagjinoja sikur të flisja
me gazetarët,
Kureshtarja ime mendon se
unë i adhuroj ato
Do të ishte që unë
Do të qëndroja përballë tyre
Ashtu siç qëndrojnë rrugët
Që komunikojnë me njëra tjetrën.
Ndjesia që lind
Është shkëlqimi i shpirtit
Në vijimësi.

NERV

Kam pak shpërthim,
nga dritat e mendjes.
Më vjen prej emocionit
dhe dua të shprehem
me fjalë.
Fjalët që rrjedhin
janë tërbim dhe zemërim.
Në atë mënyrë që ndihen,
Vijnë ndjenjat në shpirt.

SHPIRTI I JUSTIFIKIMIT TË POEZISË
(ndjenja)

Dhjetëra mendime të forta
që janë tërbim dhe zemërim
këto mendime përplasen
me njëra-tjetrën
në trurin e skuqur
prej furtunës së tij
dhe ndodh që truri
nxehet me shkreptima
nervi.

DASHURIA VAZHDON

(poezi për prindërit e mi)

Merre me vete
dashurinë tënde,
Sepse dashuria jote
është e lidhur sot.
Dhe ajo rritet me shpirt.
Ndodh që ti e ke njohur
njeriun dhe bashkohesh me të,
Dërgoje në vendin,
ku ti e ke ndërtuar
Dashurinë.
Qëndro e lumtur
Me heroin tim.

FORCA E VLERAVE TË ARTA

Njeriut që më dha shpirtin
dhe zemrën,
Njeriut që më solli realitetin,
Njeriu që më shëroi gjithçka
funksionale,
Njeriut që më sjell gjëra
të rralla,
I uroj një rrugë të hapur
dhe sa më të gjërë,
Edhe ~~100~~ vite të bëhet
Dhe ari t'i shtohet
Në mendjen e tij!

LUMTURIA DIMËRORE

E pashë veten time
Me një xhaketë të leshtë,
Ndërsa ty të pashë
Me një xhup rozë
Me disa katrorët të kuq.
Më jep ndjesinë e dridhjes
së ftohtë.
Më vjen të qesh me ty
dhe kjo ndodh
për shkak të lumturisë dimërore
Pas lumturisë dimërore
Vjen një ngrohtësi e lehtë.

LINJA E FORTË E SHPËTIMIT

Lule dita ime është e butë
Dhe është si zemër e ngrohtë
Dhe është iluzion
Dhe është simpati
Dhe për mua
është e fortë
si linja e shpëtimit
që të shpëton
nga gjithçka
që të kap dhe
të mos jesh vetëm...

NDJENJA E QETËSISË

E shtrirë si një pemë e shembur
Dhe pranë saj rri një statujë e thyer
Që po qëndron me sytë e mbyllur
Pa ndjenja dhe pa mendime
Por kjo pema e shtrirë ndihet e lodhur
Ndërsa kjo statuja ndihet e përgjumur
Ato bashkohen mes njëri-tjetrit
Dhe bashkimi jep ndjesinë e qetësisë
Ndërsa qetësia shkon tek çrregullimi i jetës
së saj

CINGUIZMA

Struci im është i çuditshëm
Sepse vetëm cinguizma ka në tru
Ai vetë është i lodhurishëm
Pasi bota ia ka të lehurën pa zhurmë
Mendja e tij është me dy veta
Dhe pika ia kap në metra
Koka e tij është si top i prishur
Edhe jeta e bën të ringritur
Asgjë nuk di se është i harruar
T'ia mbyllësh gojën është e pamendësuar
Se ai të kap mat dhe botën s'ta lë mbrapsht...

MJELLMA ME ÇLIRIZMA

Mjellma me çlirizma
që vallëzon në harmonizma
Jeta e saj është bota e bukur
Edhe vetvetja e saj është e lumtur
Mendja e saj nuk është me britma
Dhe jeta nuk mban frikëra
Pamja e saj është e qeshur
Ndërsa vetvetja është e heshtur
Detajet nuk i çon kuturu
As mendjen nuk e bën me fluturue
Dashuria i kapet në linja
Dhe mendja është pa thinja...

